



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3381 Prot.
18

Patos më 14.02.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 12.02.2024

I mbajtur sot më datë 12.02.2024 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Armand Ahmetaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Erald Çepele
4. Artan Velçani
5. Smerald Hazizaj
6. Vjollca Kasaj
7. Albiona Lamaj
8. Liljana Mesutaj
9. Ertilla Myrtaj
10. Lori Musaj
11. Novrus Toska
12. Elton Seraj
13. Suela Hoxhaj
14. Elmira Rama

Pasi verifikohet kuorumi i mbledhjes i cili plotëson 50 %+ 1 këshilltar kalohet në miratimin e rendit të ditës i cili është si më poshtë:

- 1- Miratimi i rendit të ditës .
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.01.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.01.2024.
- 4- Projekt- vendim “Mbi miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2024 nga Fondet e Trashëguara nga viti 2023”.
- 5- Projekt- vendim “Për miratimin e kontratës së qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier”.

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Armand Ahmetaj.

Përshëndetje të nderuar koleg, këshilltarë i nderuar Kryetar i Bashkisë!

Zhvillojmë këtë mbledhje jashtë radhe në zbatim të nenit 53 pika 3 gërma a të Ligjit nr.

139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, si dhe të nenit 59 të "Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin të Këshillit Bashkiak.

Kjo mbledhje zhvillohet me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë e cila mban numrin 333 prot., datë 01.02.2024

Përpara se të lexoj rendin e ditës dua t'ju informoj se kemi ndjekur të gjitha hapat, është vepruar konform Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin të Këshillit Bashkiak si në hartimin e rendit të ditës po ashtu edhe në trajtimin e çështjeve në komisionet përkatëse. Pra është mbledhur Komisioni i Ekonomisë Financës dhe Ndihmave Ekonomike për shqyrtimin e pikës 4 të rendit të ditës po ashtu dhe Komisioni i Ligjeve, marrëdhëniet me komunitetin dhe jashtë ekonomike për shqyrtimin e pikës së pestë. Po ashtu këto pika do ti kalojnë këshillit për shqyrtim dhe votim.

Armand Ahmetaj- Kalojmë në leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës .

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.01.2024.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.01.2024.

4- Projekt- vendim "Mbi miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2024 nga Fondet e Trashëguara nga viti 2023".

5- Projekt- vendim "Për miratimin e kontratës së qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier".

Kush është dakord me rendin e ditës?

Nëse nuk ka gjë tjetër, atëherë e kalojmë në votim për miratimin e rendit të ditës.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 14 vota pro.


SEKRETARI

Refaela Xeba



KRYETARI

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 333 Prot.
19

Patos më 14.02.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 12.02.2024 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.01.2024.

Armand Ahmetaj- Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjerim për korrigjim procesverbali?

Nëse ska pyetje ose sygjerime në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3331 Prot.
110

Patos më 14 02.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 12.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.01.2024

Armand Ahmetaj – Të lutem sekretare!

Refaela Xeba , Përhëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 29.01.2024 janë marrë gjithsej gjashtë vendime nga numrat 01 deri në 06, të gjitha vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 6 vendime vetëm vendimi nr. 01 i është përcjell Prefekturës për verifikim pasi në marrëveshje ishte e përcaktuar se marrëveshja hyn në fuqi dhe bëhet e zbatueshme vetëm pas miratimit nga këshillat përkatës dhe shprehjes së ligjshmrisë nga ana e Prefektit të Qarkut. Në këto kushte ne e kemi dërguar vendimin për verifikimin e ligjshmrisë dhe me shkres nr. 171/5.1 ka ardhur përgjigja se verifikimi ligjor i këtij akti nuk është në kompetencat e Prefektit të Qarkut, pra nuk është akt normativ.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 341 Prot.
6

Patos më 14.02.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 12.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt- vendim “Mbi miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2024 nga Fondet e Trashëguara nga viti 2023”.

Armand Ahmetaj- Atëherë përfaqësuesi i ekzekutivit të relatoi në lidhje me këtë pikë. Ekzekutivi relaton materialin përkatës të paraqitur .

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Albiona Lamaj- Përshëndetje! Për të qënë më të qartë, në ato tabela që ne shikojmë ne pamë që në realizimin e 2023 pothuajse në të gjitha zërat nuk ishin realizuar 100% buxheti për 2023. Për ta kuptuar më qartë këto janë projekte të cilat janë miratuar në 2023 dhe vazhdojnë të jenë akoma në 2024 apo ka zëra që realisht nuk janë realizuar 100% në buxhet dhe pse ?

Kryetari i Bashkisë- Pjesa më e madhe e atyre zërave janë projekte që ishin në fazë prokurimi për çështje fondi, u anulua si veprim në periudhën janar-shkurt dhe rikaloi përsëri këtë vit e njëjta procedurë. Një pjesë tjetër janë faturat e palikuiduara për investimet që janë bërë në 2023 dhe janë akoma në fazën e kryrjeve të punimeve. Gjëra të ndryshme domethënë në bazë të projekteve që janë bërë. Të parealizuara nuk besoj se ka, mund të jenë fondet e papërdorura fare por pa një destinacion nuk ka, mund të jetë një vlerë e vogël fare. Vlera fiks ka qënë tetëdhjetë milion e cila ka kaluar në fund të vitit nga buxheti i shtetit plus dhe një pjesë tjetër u bënë bashkë dhe kaluan për rikonstruksionin e kopshtit. Dhe duke qënë se ishte dhe viti i pyjeve kemi menduar dhe nxorëm një fond për mbjellje pemësh për të bërë disa pyjëzime. E kemi gati dhe pjesën ku do të bëhen këto pyjëzime, besoj shumë shpejt nëse do të miratohet ditën e sotme do vazhdojmë me procedurat për mbjelljen e pemëve, janë disa zona që janë evidentuar nga Drejtoria e Bujqësisë. Në mos gaboj janë planifikuar rreth 4000-5000 fidanë.

Mimoza Shërmbari- Drejtore e Financës dhe Shërbimit Social. 30 milion e 837 mijë që vjen si transfertë shtesë e pakushtëzuar është pikërisht kjo që foli kryetari. 18 milion e 600 mijë na ka ardhur me aktin normativ në fund të vitit 2023 dhe 12 milion e 800 mijë ka ardhur shtesë transferte gjatë vitit për rritjen e pagave. Ndërsa mosrealizimet përkatëse sipas burimeve përpos që ne kemi faturat të dhjetorit, kontrata që janë vazhdim likuidimi dhe objekte në proces prokurimi ka dhe çlirim fondi midis buxhetimit dhe vlerës fituese. Por këto do t'ju vijnë të analizuar në raportin e monitorimit që do të vij në mars për buxhetin e vitit 2023.

Novrus Toska- Te zëri i bujqësisë dhe ujitje kullim, bujqësia është realizuar në masën 70% ndërsa ujitje kullim në masën 24%. Çfarë zërash kanë ngelur pa u realizuar?

Kryetari i Bashkisë- Tek pjesa e ujitje kullimi një pjesë të mirë zë dhe projekti i ndërtimit të stacionit të pompimit si fond, tani do riprokuohet përsëri.

Suela Hoxhaj- Çfarë ndodh me fondet e papërdorura 2023 të cilat nuk janë përdorur ? Mund të digjen apo mund të përdoren duke krijuar diçka tjetër emergjente ndoshta me projekte apo gjëra që do të zhvilloi ekzekutivi ? Tek pjesa fonde të papërdorura 2023 ka një buxhet aty?

Kryetari i Bashkisë- Kalojnë në 2024.

Suela Hoxhaj- Nuk është se digjen, nuk është se keto duhet patjetër të shfrytezohen brenda atij viti të caktuar por që përdoren. Është plus domethënë atij fondi që do të kemi këtë vit apo jo?

Drejtores e Financës- Ne pikërisht këtë po kërkojmë të miratojmë, fondet e papërdorura për vitin 2023 të detajuar sipas analizave, çfarë janë në proces përpunimi, çfarë janë lidhje kontratash, çfarë janë me faturë.

Erald Çepele – Sa për sqarim tek fondet e papërdorura 229,529,263 lekë dhe këtu pak më poshtë thuhet se vlera prej 171 milion 256 mijë do të shpërndahet përsëri për financimin e projekteve të investimeve të miratuara në këshill me buxhetin e vitit 2023, mos duhet të ishte 2024?

Drejtores e Financës- Po jo pra, projektet janë miratuar në vitin 2023 dhe do vazhdojmë ti financojmë në 2024 sepse procedurat kanë zgjatur ose janë në proces të punimeve.

Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së katërt Projekt- vendim “Mbi miratimin e buxhetit shtesë për vitin 2024 nga Fondet e Trashëguara nga viti 2023”.

Kush është dakord?

14 vota pro, abstenim ska, kundër ska, miratohet.

SEKRETARI

Refaela Xeba



Smerold Hazaj



KRYETARI

Armand Ahmetaj



Albiona Lamaj



Lori Musaj Mys



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 24 / Prot. 14

Patos më 14 02.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 12.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt- vendim “Për miratimin e kontratës së qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier”.

Armand Ahmetaj - I lutem ekzekutivit!

Nurkë Hazizaj – Përshëndetje të gjithëve! Projekt- vendim “Për miratimin e kontratës së qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë si palë qiradhënëse dhe Bashkive të Qarkut Fier si palë qiramarrëse”. Me vendimin nr. 64 të datës 30.10.2023 u dha dakordësia nga ana juaj për marrjen më qira me tarifë 1 euro nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë të rrugës hyrëse, peshores dhe vend depozitimit të mbetjeve urbane. Pas dhënies së dakordësisë nga ana juaj ka ardhur dhe nënshkrimi i kontratës së qirasë nga Kryetari i Bashkisë i cili mban numrin 246 prot., datë 26.01.2024. Kjo kontratë qiraje ka një afat një vjeçar me të drejtë rinovimi dhe fillon nga data 18.01.2024 dhe përfundon në 17.01.2025. Vlera siç e thamë është në vlerë simbolike 1 euro.

Një nga detyrat kryesore të palës qiradhënëse që është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë është dorzimi i sendit në datën e fillimit të qirasë dhe në gjendjen fizike që palët kanë rënë dakord.

Një nga detyrat kryesore të palës qiramarrëse që janë Bashkitë e Qarkut Fier është marrja në dorzim të sendit brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë kontratën e qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier nr. 246 prot datë 26.01.2024. Bashkëlidhur projektvendimit gjendet dhe kontrata e qirasë.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së pestë Projekt- vendim “Për miratimin e kontratës së qirasë të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier”. Kush është dakord?

14 vota pro, abstenim ska, kundër ska, miratohet.

SEKRETARI

Refaela Xeba

KRYETARI

Armand Ahmetaj

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 333 Prot.

Patos më 14.02.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 12.02.2024 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak,

Diskutime të tjera.

Smerald Hazizaj- Dua t'ju kërkoj ndjesë duke kërkuar dhe mirëkuptimin e kolegëve do dal pak jashtë rendit të ditës për të drejtuar dy pyetje nëse do me jepet mundësia. Po ngre dy shqetësime dhe problematika të lagjes Mustafa Matohiti dhe më gjere të Reresit, Margëlliçit Dukas pak më lart, flas këtu për linjën e Transportit Publik, sot në këto kushte nëse ka mundësi nga ana e ekzekutivit ose nga ana juaj të vihet në dispozicion një njoftim se ku është sepse realisht është bërë një problem shumë i madh. E dyta është rruga kryesore e Lagjes Mustafa Matohiti, unë e di që nga ana e bashkisë ka një projekt por lagështia, terreni e ka bërë shumë të vështirë rrugën e Dukasit aty ku është dhe problemi, por unë kërkoj një mirëmbajtje nga ana e bashkisë qoftë më çakull pasi është bërë dhe më përpara dhe ajo rrugë sa po vjen dhe po bëhet e pakalueshme. Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë- Për pjesën e linjës është diçka që nuk varet nga Bashkia, pjesa që të detyroj dikë të mari atë linjë dhe ata përdori. Ajo është që dikush ta mari dhe ta përdori atë linjë dhe të mari licensën që ta përdori atë linjë. Aktualisht ka patur shprehje interesi deri diku pastaj janë tërhequr. Ndërsa për rrugën do ta vlerësojmë dhe do ta shikojë çfarë mund të bëjmë. E kemi çuar të gjithë rrugën tek Fondi Shqiptar Zhvillimit nga Patosi deri në Patos Lart dhe presim përgjigje akoma sepse ajo është një gjë që te Fondi i Zhvillimit si aplikim shtrihet deri në fund të këtij viti mund të jetë dhe një pjesë e 2025.

Smerald Hazizaj- Faleminderit Kryetar për sqarimin! Unë do të doja të jepja një mendimin tim nëse më lejohet flas këtu për taksitë e vogla 4+1 mesa di unë këto taksi kur e marin licensën nga ana e bashkisë ju bëhet me përcaktim destinacioni që ato do të shërbejnë dhe nëse këto bëhen me përcaktim rruga terreni pse mos te vihen në dispozicion të Transportit Publik Patos.

Kryetari i Bashkisë- Nuk mund të vendoset taksi për Transport Publik pasi taksia nuk është Transport Publik.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Smerald Hazizaj

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Albina Lamaj

Lori Musaj

Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza".

